



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR, PARTIA "BINDJA DEMOKRATIKE" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, Partia "Bindja Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 64, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datës 05.11.2018 ka caktuar datën 30 qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Z.Fabian Topollari, përfaqësuesi në emër dhe për llogari të Partisë "Bindja Demokratike", ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 30 qershor 2019, administruar me nr.2499 prot., datë 23.04.2019.

Nr. 230 i Vendimit

Data 27.04.2019

Ora 10:00 e Vendimit

Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, Partia "Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019



Kërkesa e paraqitur është depozituar brenda afatit kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Bashkëlidhur kërkesës Partia "Bindja Demokratike" ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetimi nr. 1160/1. Prot, datë 26.04.2019, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 26.04.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 8 datë 25.04.2019, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë, ka vendosur regjistrimin si person Juridik të Partisë "Bindja Demokratike" në regjistrin e partive politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Kryetar i përkohshëm është z. Astrit Patozi, emrin zyrtar, shkronjat nistore, adresën e partisë, dhe specimenin e vulës së partisë;
- emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të përkohshëm të partisë;
- shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- specimeni i vulës së partisë;
- emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (zj. Estela Kondura);
- emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z. Fabian Topollari);

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas verifikimeve përkatëse dhe konstatimit se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia "Bindja Demokratike", janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë Partinë "Bindja Demokratike", me kryetar z. Astrit Patozi, dhe shkronja nistore "BD", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Nr. 230 i Vendimit

Data 27.04.2019

Ora 10:00 e Vendimit

Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, Partia "Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

